

VENDIM
Nr. 152, datë 20.3.2019

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE ZVOGËLIMIN
NË VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 12 HA, QË DO TË PËRDORET NGA “DEVOLL
HYDROPOWER” SHA PËR SHFRYTËZIMIN E GURIT GËLQEROR NË OBJEKTIN
“POPÇISHT”,
BASHKIA MALIQ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 12 ha, që do të përdoret nga “Devoll Hydropower” sh.a. për shfrytëzimin e gurit gëlqeror në objektin “Popçisht”, Bashkia Maliq, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullor publik i bashkisë, të zvogëlohet në volum dhe të çregjistrohet nga Regjistri i Kadastrës së Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja nr. 1, me të dhënat për sipërfaqet pyjore që zvogëlohen në volum dhe hiqen nga fondi pyjor dhe kullor publik, si dhe harta topografike me koordinatat e poligonit të sipërfaqes objekt mineral, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor, të produkteve të tjera pyjore dhe kullorë dhe të investimeve të kryera në vite, në sipërfaqen objekt mineral, paguhet nga “Devoll Hydropower” sh.a., në llogarinë rrjedhëse të Bashkisë Maliq, në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, “Devoll Hydropower” sh.a. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet sipas kushteve të lejes mjedisore dhe të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe pyjore prej 12 ha, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshje me Bashkinë Maliq.

4. Bashkia Maliq dhe “Devoll Hydropower” sh.a. nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit jo më vonë se 60 ditë, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Një kopje e marrëveshjes, së bashku me projektin e miratuar për pyllëzimin, dërgohet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, jo më vonë se 10 ditë, nga data e nënshkrimit të saj.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas lidhjes nr. 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore të identifikuar sipas lidhjes nr. 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë pyjore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet mineral”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit sipas lejes mjedisore nga “Devoll Hydropower” sh.a., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullor publik të Bashkisë Maliq.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Maliq dhe “Devoll Hydropower” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe



Bashkia MALIQ

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HËNEN
PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAR TË SHOQËRISË "DEVOLL HYDROPOWER" sh.a.

Nr.	ID Pronës	Ekonomia Pyjore/Kullosore	Ngastrat n/ngastrat	Sipërfaqja që hiqet nga fondi pyjor/kullosor HA	Përdorimi i territorit
1	2	3	4	5	6
1	KO 048 00 031a	EP Moglicë	31 a	12.00	cungishte

GJITHSHEJ

MINISTËR
Blendi KLESI
TIRANE

MINISTËR
Damian GJIKURI
TIRANE



